



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 104, datë 29.02.2024

**PËR
PËRSËRITJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARIT {...} NË
GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” i ndryshuar, si dhe duke mbajtur në konsideratë dhënien e pëlqimit të gjyqtarit {...}, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë deri në 13.03.2025.
2. Efektet e këtij Vendimi fillojnë nga data 13.03.2024.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit {...}, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR